

**VENDIM**  
**Nr. 556, datë 29.7.2022**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 101, DATË 9.2.2022,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË  
TË SEKTORËVE, QË DO TË MBËSHETETEN DHE TË MASËS SË FINANCIMIT  
NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL, PËR  
VITIN 2022 ”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 3, e 36, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 101, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në nënpikën 2.1, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “dh”, me këtë përmbajtje:  
“dh) Mbështetje për kultivimin e grurit, për sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 ha, në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për ha.”.
2. Në pikën 2.2, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:  
“d) Mbështetje me 40 (dyzet) lekë për litër të karburantit për anijet e peshkimit, për furnizimet, nga data 1 korrik 2022 deri më 31 dhjetor 2022.”.
3. Në nënpikën 2.5.1, shifra 1 450 000 000 (një miliard e katërqind e pesëdhjetë milionë) lekë zëvendësohet me shifrën 1 950 000 000 (një miliard e nëntëqind e pesëdhjetë milionë) lekë.
4. Efektet financiare shtesë prej 1 200 000 000 (një miliard e dyqind milionë) lekësh, që shoqërojnë miratimin e këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e kontingjencës për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**